

## NJOFTIM

**Drejtuar:** Agjencise Kombetare te Mjedisit

**Lenda:** Kerkese per zhvillimin e procedures se degjeses me publikun

Shoqeria “APEK servis plast” Sh.p.k njofton Agjencine Kombetare te Mjedisit per zhvillimin e procedures se informimit te publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit B per instalimin:

Prodhimi i produkteve plastike, me vendndodhje: Zona Industriale Gjirokastrë, “Reperti i zdrukthtarisë”.

Ky njoftim hartohet Referuar VKM 419, date 25.06.2014, Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” te ndryshuar, kreu VI “Informimi dhe pjesëmarrja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B”, bashkangjitur gjeni dokumentacionin e kerkuar, sipas pikes 2 te ketij kreu:

- a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për “**Aplikim për leje mjedisi të tipit A** ose të tipit **B**” apo “Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B”.
- b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
- c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
- d) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
- e) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkomunikimtar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
- f) Konsultimet ndërkomunikimtare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
- h) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit

- a. Kërkesa për vendosjen në funksionim të instalimit “Prodhimi i produkteve plastike” është për aplikim për lejes të re mjedisore të tipit B, sipas Shtojces 1, të Ligjit Nr. 52/2020, Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar”:

- Prodhimi i produkteve plastike

ID 7.13. Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të kësaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike.

b. TË DHËNAT E EKSTRAKTIT TË QKR-SË;



**EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”**

**GJENDJA E REGJISTRIMIT**

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	M42817601M	
2. Data e Regjistrimit	17/04/2024	
3. Emri i Subjektit	APEK servis plast	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	15/04/2024	
6. Kohëzgjatja	Nga: 15/04/2024	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Gjirokaster Gjirokaster Qyteti Gjirokaster, godina me Nr Pasurie 24/X, Zona Kadastrale 8543.	
8. Kapitali	100.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	2,00	
9. Objekti i aktivitetit	Import, prodhim, shitje, qeska me pakice dhe shumice, ambalazhe, paketim, letra, qese dhe importe të ndryshme.	
10. Administratori/ët	Ergys Karaj	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 15/04/2024	Deri: 15/04/2029
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	PerikliJorgji	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 50.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	
<i>- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)</i>		
13. Ortakët	ErgysKaraj	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 50.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	50,00	

- Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse zotëron kuotën si përfaqësues)	
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: APEK servis plast E-Mail: ergys1985karaj@gmail.com Telefon: 0692248849
16. Statusi:	Aktiv

Lista e Dokumenteve:

Statuti (nese eshte hartuar si dokument i ndryshem nga akti i themelimit)

Akti i themelimit

Regjistrimi Fillestar: CN-274567-04-24


### HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i te dhenave te regjistruara
---------------------	--

Data: 14/05/2024

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)

**c. ADRESËN E VENDNDODHJES SË INSTALIMIT;**

Emri i instalimit/impianit <sup>1</sup>	<b>Prodhimi i produkteve plastike</b>										
Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianiti	Qarku Gjirokastrë, Bashkia Gjirokastrë, Zona Industriale Gjirokastrë, “Reparti i zdrukthtarisë”.										
Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4	<table border="1"> <tr> <th colspan="3">Koordinata e vendodhjes se aktivitetit në sistemin Gaus-Kruger</th> </tr> <tr> <th>Nr.</th> <th>Koordinatat X</th> <th>Koordinatat Y</th> </tr> <tr> <td>1</td> <td>4437266.19</td> <td>4428696.15</td> </tr> </table>		Koordinata e vendodhjes se aktivitetit në sistemin Gaus-Kruger			Nr.	Koordinatat X	Koordinatat Y	1	4437266.19	4428696.15
Koordinata e vendodhjes se aktivitetit në sistemin Gaus-Kruger											
Nr.	Koordinatat X	Koordinatat Y									
1	4437266.19	4428696.15									
											
Kategoritë aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi <sup>2</sup>	<b>ID 7.13. Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të kesaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike.</b>										
Kapaciteti i projektuar	Me kapacitet të barabartë ose më të madh se 50 ton/vit.										

<sup>1</sup> Përshkruaj titullin sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit

<sup>2</sup> Shkruani kodet e specifikuar në kollonën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuar në kollonën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

### Pozicionimi i objektit ne imazh satelitor



#### **d. PËRSHKRIMIN E VEPRIMTARISË QË PARASHIKOHET TË ZHVILLOHET NË INSTALIM;**

Subjekti “APEK servis plas” Sh.p.k, me seli qendrore ne: “Gjirokaster, Gjirokaster, Qyteti Gjirokaster, godina me Nr.Pasurie 24/X, Zona Kadastrale 8543” me administrator Z. Ergys Karaj është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, per veprimtarine: “Import, prodhim, shitje, qeska me pakice dhe shumice, ambalazhe, paketim, letra, qese dhe importe te ndryshme.”, etj., me Nr NIPT: M42817601M.


Per kete qellim, shoqeria “APEK servis plas” Sh.p.k referuar Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 “Per Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014 “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja” te ndryshuar, ka plotesuar Formularin e Kerkeses per tu pajisur me Leje Mjedisit te Tipit B per aktivitetin Prodhimin i produkteve plastike (Prodhimi i filmit te plastmasit) me vendndodhje ne Zona Industriale Gjirokastër, “Reparti i zdrukthtarisë”. Shoqeria ka siguruar staf dhe pajisje profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti.

Vendosja e ketij instalimi ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara dhe ndodhet ne zone industrial. Ne kete zone eshte perqendruar nje numer i madh i bizneseve me karakter industrial e sherbime.

Aktiviteti do te zhvillohet ne nje godine 1-kateshe ekzistuese, ambjent i pershtatshem per kete qellim, duke mos krijuar keshtu deme apo efekte negative te ndryshme ne mjedisin perreth.

Siperfaqja e prones ku ushtrohet aktiviteti eshte e llojit ndertese dhe zhvilluesi ka kontrate qiraje me pronarin ligjor te objektit. Kontrata eshte nenshkruar ne prani te noterit, per rregullimin e marredhenieve te pronesise dhe te drejten e zhvillimit.

Aktiviteti i shoqerise “APEK servis plas” Sh.p.k per “Prodhimin i produkteve plastike” sipas Planit te Detajuar Vendor te Bashkise Gjirokastrër do te zhvillohet ne Njesine Stukturore: ZE.7.7



**Disa nga makinerite qe do te perdoren ne kete aktivitet jane:**

**-Makineri filmi plastik me një shtresë**

Keto makineri perdoren per te prodhuar filma plastikë (Plastmas) me një shtresë duke përdorur materiale të ndryshme plastike si polietileni (PE) dhe polipropileni (PP), LDPE HDPE, i cili përdoret gjerësisht në: filmin per paketimit, filmin per mbulues bujqësor, film per paketimin e tekstilit, qesen e veshjeve, qesen e blerjeve, qesen plastike, qesen e mbeturinave dhe zona të tjera paketimi. Trashësia e produktit, prodhohet brenda stadartit te lejuar me ligj (VKM Nr. 367, datë 30.5.2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve Përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, Prodhimit, importimit apo futjes në territorin e republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike Mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme”), e cila eshte mbi 70 mikron. Karakteristikat kryesore të këtyre makinave përfshijnë shpejtësinë e lartë të prodhimit, prodhimin e filmave me trashësi uniforme dhe efikasitetin e energjisë. Ato janë gjithashtu të pajisura me teknologji të ndryshme nxjerrjeje dhe formimi që mund të rregullohen sipas llojit të materialit të përdorur dhe vetive të dëshiruara të filmit. Sa i perkete permasave te produkteve, ato do te jene ne perputhje me standartin e lejuar. Qeset e paketimit do te jene me kapacitet mbajtës më të vogël se 10 (dhjetë) kilogramë dhe me përmasa më të vogla se 50 (pesëdhjetë) cm gjatësia dhe 24 (njëzet e katër) cm gjerësia, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve.



#### **-Makinë stampimi ne plastike:**

Makina e stampimit është e përshtatshme për materiale printimi në rrotullim si HDPE, LDPE, letra dhe pëlhura jo të endura, por ne rastin tone do te perdoret vetem per produktet plastike.

Makineritë e tilla përdoren gjerësisht në industrinë e paketimit për printimin në materiale të tilla edhe si polietileni (PE), polipropileni (PP), poliesteri (PET) dhe filma plastikë të tjerë fleksibël. Stampimi favorizohet veçanërisht për aftësinë e tij për të prodhuar vëllime të mëdha të materialit të printuar me shpejtësi të lartë me një kosto relativisht të ulët për njësi.



**-Makineria e formes dhe prerjes automatike:** Eshte makineri për prodhimin e qeseve plastike, me shpejtësi të lartë të kontrollit elektronik të lëvizjes.

Eshte makineria baze per te bere te mundur mbylljen e pjeses fundore te qeseve plastike, dhe prerjen ne formen e duhur sipas kerkesave te prodhuesit.

Veçoritë e kesaj makinerie jane:

- E disponueshme për dizajn të veçantë me ngarkesë maksimale
- Pajisjet janë të pajisura me dizajn të prerjes me thikë të ftohtë
- Vendosja e gjatësisë, shpejtësia e makinës, numërimi i qeseve mund të kontrollohet dhe ndryshohet lehtësisht në panelin e ekranit.
- Sensorët e kontrolleve të rrotullave të filmit sigurojnë një linjë të përsosur te mbyllur dhe pa tension.
- Sensori i printimit siguron saktësinë e rrotullës së qeseve të printuara



### **-Makineri prerese dhe vulosje/mbyllje me nxehtesi**

Kjo makineri e automatizuar ka karakteristika te tilla si: gjatesi e caktuar nepermjet kompjuterit, performanca e qendrueshme, shpejtësia e lartë. Pjeset perberese te kesaj makineria jane: rulat anilox ku vendoset filmi plastik, rualat prej gome, pajisje vrimesh, thikat qe bejen mbylljen e pjeses fundore te qeses, me pas behet vulosja me nxehtësi dhe prerja me nxehtësi e produktit dhe me pas nepermjet rripit transportues produkti plastik perfundimtar kalon ne mbajtësen e makinerise.





### **-Makineri per prodhimin e qeseve plastike ne forme cante.**

Pasi filmi plastik kalon nepermjet rulave anilox ne pjesen ku behet vulosja dhe prerja me nxehtësi, produkti kalon ne hapin tjetër qe është pajisja shtypës/prerës automatike, e cila ben te mundur prerjen e nje numri te caktuar te qeseve ne formen e caktuar, (forma cante ose T-shirt). Pjeset e mbetura te qeseve plastike qe mbesin pas prerjes, nepermjet nje rripi transportues, mblidhen ne nje vend te caktuar qe nuk pengojne ne vazhdimesine e procesit dhe riperdoren ne procesin e prodhimit.



### **Furnizimi me energji elektrike, ndricimi etj,**


Furnizimi me energji elektrike, per nevojat e fuqise motorike dhe te ndricimit, do te behet permes linjes elektrike qe vjen nga kabina elektrike e ndodhur ne afersi te prones. Ne rast nderprerje te energjise elektrike mund te parashikohet vendosja e nje gjeneratori, i cili do te siguroje vazhdueshmerine e punes ne objekt. Energjia elektrike përdoret kryesisht për funksionimin e makinerive te prodhimit dhe ndriçimin e ambjeteve të punës, etj.

### **Furnizimi me uje dhe kanalizimet**

Furnizimi me ujë bëhet nga Rrjeti Ujësjellës Kanalizime i zonës. Te gjitha ujerat qe dalin nga shfrytezimi i objektit, te reshjeve atmosferike si dhe shkarkimeve higjeno-sanitare, sistemohen ne kanale ujembledhes dhe behet orientimi i tyre per ne sistemin e kanalizimeve te zones. Ujerat qe dalin nga aktiviteti human ne objekt jane ujera te perdorura urbane, te cilat do te shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones. Burimi i vetem i ujerave te perdorura do te jete nga ambjentet Higjieno-sanitare, pra aktiviteti human.

## Rrugët hyrëse për në objekt dhe rrugët e brendshme

Objekti ndodhet në perëndim të rruges kryesore Gjirokaster-Jergucat. Objekti ndodhet në rrugën "Iljaz Bobi", e cila është dhe rruga hyrëse për në objekt. Kjo rrugë ndodhet në anën perëndimore të objektit, çka bën të mundur që ky objekt të mos ndikojë drejtperdrejtë në trafikun e rrugës kryesore të zonës. Rruga e cila krijon akses në hyrje të objektit, është ekzistuese dhe përreth objektit ka hapësirë të mjaftueshme për levizjen e personelit, makinave që frekuentojnë këtë objekt si dhe të mjeteve zjarrfikëse.



## **e. PERMBLEDHJA NE GJUHE JO-TEKNIKE**

Permbledhja duhet te perfshije informacionin e meposhtem:

- **INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ;**

### **Prodhimi i produkteve plastike**

ID 7.13. Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të kesaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike.

- **LENDET E PARA DHE ATO NDIHMESE, SUBSTANCAT E TJERA DHE ENERGJIA E PERDORUR OSE E GJENERUAR NGA INSTALIMI;**

Si lende e pare per kete proces pune do te perdoret produkt i gatshem i plastikes, ne forme kokrrize (e granuluar), i cili vjen i paketuar.

- **IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS**

### **Shkarkime ne uje**

Ujrat higjeno-sanitare të gjeneruara nga ky aktivitet do të shkarkohen në rrjetin e kanalizimeve. Mund te permendim vetem ujerat higjenosanitare te ambjenteve te tualeteve dhe te larjes e pastrimit te ambjenteve te punes. Keto ujera shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones.

### **Emetimet ne ajer**

Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit në zone. Të vetmet shkarkime në ajër do të jenë ato të cilat gjenerohen nga lëvizja e mjeteve që përdoren në funksion të aktivitetit, të cilat në pikëpamjen mjedisore dhe shëndetësore këto ndikime mund të konsiderohen të papërfillshme.

### **Zhurmat dhe vibrimet**

Zhurma në nivele minimale do të gjenerohen nga mjetet e transportit, të cilat përdoren nga kompania. Gjithashtu dhe nga makineritë për përdoren për proceset teknologjike në këtë subjekt. Këto zhurma do të jenë brenda normave të lejuara, duke mos shkaktuar shqetësim për banorët e zonës.

### **Ndikimi ne toke**

Ndikime ne toke nuk do te kete pasi eshte objekt ekzistues. Proceset e punes nuk do te ndikojne ne toke, pajisjet dhe makinereti jane te mekanizuara, te izoluara dhe te projektuara ne menyre te tille qe mos te kete ndikim ne toke. Nuk ka perdorim dhe magazinim te lendeve te rrezikshme. Nuk vlersohen ndikime negative në karakteristikat fizike të zonës ku zhvillohet kjo veprimtari. Kemi të bëjmë me një zonë industrial. Ndikimet ne toke nga infrastruktura, nuk ka pasi kjo zone eshte e zhvilluar dhe urbanizuar dhe rruget jane ekzistuese, nuk do te ndertohet rrjet elektrik i ri e i ujesjellesit.

### **Ndikimi ne Biodiversitet**

Kjo zonë nuk bën pjesë në zonat e mbrojtura me ligj sipas verifikimeve të kryera në portalin gjeohapësinor shtetëror [asig.gov.al](http://asig.gov.al), ky ndërtim nuk prek zonat me biodiversitet.

Distanca qe ruan projekti i propozuar, me Zonen e Mbrojtura te rajonit eshte rreth 323.8m larg Parkut Kombetar "Lumi Vjosë", ne kufirin me te afert te tij.

## Distanca objektit ku zhvillohet aktiviteti per prodhimin e produkteve plastike me Zona e Mbrojtur Parku Kombetar “Lumi Vjosë”



### **Ndikimi ne Mjedisin Social**

Ndikimi i ketij projekti ne mjedisin social, pritet te jete me efekte positive persa i perkte punesimit te banoreve te zones dhe ofrimit te sherbimit te ketij lloj aktiviteti, duke qene se ne zonen ne fjale nuk ka nje te tille.

### **Mbetjet teknologjike**

Mbetjet plastike te prodhimit te produktit nga prerja e tij ne format e permasat e kerkuara. Keto mbetje rifuten ne procesin e prodhimit.

### **Mbetjet e ngurta urbane**

Mbetjet e ambalazheve dhe ato nga aktiviteti human te punonjesve konsistojne ne gjenerimin e mbetjeve urbane ne fraksione te ndara. Mbetjet urbane grumbullohen ne fraksione te ndara duke perdorur sistemin me tre kosha: 1-leter dhe karton, 2-plastike, 3-qelq. Keto mbetje terhiqen nga sherbimi i pastrimit urban te zones, kundrejt tarifes qe i paguhet Bashkise per kete qellim.

## Qendrat e banuara ne zone

Objekti ne te cilen zhvillohet aktiviteti ndodhet ne Zonen Industrial e Qytetit te Gjirokastrës. Referuar portalit shtetëror e-Planifikimi, sipërfaqja ku ndodhet godina me funksion industrial, ben pjese ne Njesine Strukturore ZE.7.7) ne kategorine IE. Industri dhe ekonomi 100%. Distanca e objektit ku zhvillohet aktiviteti me qendren e qytetit Gjirokastrë eshte rreth 2.65km larg, ndersa qendrat më te aferta te banuara jane fshatrat: Kordhoce, Lazarat dhe Arshi Lengo. Objekti ku zhvillohet aktiviteti kufizohet ne Veri, Lindje dhe Jug nga objekte industriale dhe ne Perendim nga nga rruga “Iljaz Bobi”.



- **ALTERNATIVEN NE LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TE INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINE E PERDORUR;**

Subjekti "APEK servis plas" ka marre me qira godinen ku zhvillohet veprimtaria e cila eshte i pozicionuar ne Zona Industriale Gjirokastrë, "Reparti i zdrukthtarisë", Bashkia Gjirokastrë. Prona ku do te zhvillohet veprimtaria eshte nje godine I-kateshe ekzistuese, e ndertuar me mure tulle, me ambjent te pershtatshem per kete aktivitet duke mos krijuar keshtu deme apo efekte negative te ndryshme ne mjedisin perreth. Gjithashtu, referuar portalit shteteror e-Planifikimi, sipërfaqja ku ndodhet godina me funksion industrial, ben pjese ne Njesine Strukturore ZE.7.7) ne kategorine IE. Industri dhe ekonomi100%.

- **MASAT PER PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NESE ESHTË E NEVOJSHME);**

Instalimet per te cilat kerkohej pajisja me leje mjedisi konsistojne ne prodhimin e produkteve plastike per te cilat eshte sqaruar me lart proceset qe zhvillohen per secilin nga instalimet. Me poshte po paraqesim ne vija te pergjithshme:

Objektivat e projektit te rikuperimit te mbetjeve jane:

- Ndertimi i nje rrjeti te menaxhimit te integruar te mbetjeve brenda siperfaqes ku ushtrohet veprimtaria
- Mbetjet urbane te papedorshme te grumbullohen transportohen dhe depozitohen ne oraret e caktuara nga Njesia Vendore.
- Te realizohet ndricimi perreth.
- Te kryhet rregullimi i territorit ne perputhje me kondicionet urbane te percaktuara.
- Shoqeria te operoje ne perputhje te plote me normat qe jane ne fuqi, dhe te kryej monitorime te vazhdueshme te tregueseve mjedisor te trysnise ne mjedis.
- Te respektoje te gjitha rregullat e mbrojtjes kundra zjarrit gjate operimit ne ndertese dhe te respektoje rregulloren e MKZ.
- Mbetjet e rrezikshme te grumbullohen, transportohen dhe asgjesohen nga subjekte te licencuara.
- Per te minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, te limitohen proceset e zhurmshme gjate oreve me te ndjeshme, ndermjet ores 20 deri ne 07 te mengjesit.
- Te respektoje te gjitha kushtet dhe masat qe do te vendosen nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

- **MASA TE TJERA TE PLANIFIKUARA NE PERPUTHJE ME PARIMET E PERGJITHSHME QE RREGULLOJNE DETYRIMET THEMELORE TE OPERATORIT, DMTH:**

Per plotesimin e kerkesave te klienteve, rritjen e cilesise se sherbimit te ofruar, rritjen e masave te sigurise gjate procesit te te punes, mbrojtjen nga gazrat, pluhurat, zhurmat, etj, mbrojtjen e shendetit te punonjesve dhe komunitetit te zones perreth, me qellim kryesor "Mbrojtjen e Mjedisit", perdorimin e energjise ne menyre eficente.

**Raportimi i masa te ndermarra per programin e permiresimit te operimit**

Raportimi i masave qe do te ndermerren ne objektin ku ndodhet instalimi per prodhimin e produkteve plastike, do te kryhet nga subjekti "APEK servis plast", sipas nje kalendari dhe regjistri te vecante, i cili do te plotesohet nga drejtuesi teknik i punes ne impiant dhe do te raportohet prane Agjencise Kombetare te Mjedisit, me miratimin e Perfaqesuesit Ligjor, Z. Ergys Karaj.

### **Masa lehtesuere te tjera te kerkuara/ndermarra**

- Te mirembahen mjediset e gjelberuar ne menyre te perhershme dhe te mbillen edhe bime decorative autoktone ne kushte artificiale per te rritur koeficientin e gjelberimit.
- Te shmanget ne maksimum perdorimi i mjeteve te transportit kur nuk eshte e nevojshme dhe te reduktohen zhurmat ne oret e vona.
- Te reduktohet qarkullimi ne oret e pikut te trafikut, per te mos krijuar trafik te renduar ne zone.
- Te vendosen kontener per mbajtjen paster te ambienteve nga mbetjet urbane per numrin e punonjesve.
- Subjekti te respektoje detyrimet e vendosura ne Lejen Mjedisore qe do te miratohet nga AKM.
- Subjekti te respektoje dhe zbatoje kushtet teknike ne objekt per mbrojtjen nga zjarri dhe te krijojte infrastrukturen e nevojshme per zjarrefikset.
- Si rezultat i realizimit te projektit nuk do te absorbohen ndikime te rendesishme mjedisore, sociale ne shendetin e njerezve. Per pasoj ndikimet e parashikuara mund te minimzohen duke zbatuar masat e permendura me siper.
- Eshte detyre e zbatuesve te projektit te integrojne elementet e domosdoshem te propozuar per parandalimin, minimizimin dhe eleminimin e ndikimeve negative ne mjedis, shendet dhe aspektin social.

### **Masa lehtesuere te tjera te kerkuara:**

- Do te behet nje menaxhim sa me me eficient te energjise elektrike
- Percaktimi i vend-parkimit te automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistiken perkatese.
- Subjekti te kryej aktivitetin prodhimin e perodketeve plastke vetem brenda kordinatave te siperfaqes se tokes qe disponon me qira.
- Do te kontrollohen kushtet teknike te mjeteve te punes ne menyre periodike
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punes do te zevendesohen me te reja, sipas jetegjatesise se tyre
- Maksimizimi i perdorimit te lendes se pare
- Mbajtja paster e ambienteve dhe pajisjet/mjetet ku zhvillohet aktiviteti me qellim plotesimin e kushteve Higjeno-Sanitare.
- Do te behet menaxhimi i mbetjeve te ngurta, te cilat do te jene; lende te aballazheve, letra-kartona, si dhe lende organike te prodhuara nga punonjesit dhe klientat, ku keto mbetje do te transportohen rregullisht ne vendin e caktuar nga Njesia Vendore, ku firma do te marre masa per menaxhimin e ketyre mbetjeve te ngurta, do te vendosen ne kosha selektive sipas rrymave specifike te mbetjeve.
- Rrjeti elektrike eshte togezuar per te shmangur ndonje shkarkese elektrike, konform kushteve teknike,
- Jane ndermarre te gjitha masat e domosdoshme te mbrojtjes kundra zjarrit.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturen e nevojshme, me distancat e percaktuara per rruge kalim te punonjesve, automjeteve, zjarrefiksive, etj.
- Do te behet trajnimi periodik i punonjesve mbi kushtet e sigurimit teknik gjate operimit te punes, si dhe te kualifikohen stafi pergjegjes per operimin e punes ne instalimet per, riparimin, mirembajtjen e pajisjeve dhe mjeteve.

### **Kerkesa shendetesore dhe mjedisore gjate fazes ushtruese te veprimtarise**

Per parandalimin e ndikimeve negative ne shendet e ne mjedis qe mund te lindin gjate ushtrimin te aktivitetit nga shoqeris "APEK servis plast" ne fushen e "Prodhimit te produkteve plastike", do te kete parasysh dhe te respektoje rigozorisht kerkesar e Rregullores Nr. 1, date 15.03.2006 "Per parandalimin e ndikimeve negative ne shendet e ne mjedis", ku investitori do te marre masa kryesore sic jane:

- Subjekti do te zbatoje kerkesat e lejes mjedisore si dhe normat e standartet qe kane te bejne me mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndikiment negative te veprimtarise,
- Subjekti do te siguroje zbatimin e masave qe parandalojne ndotjen e mjedisit dhe shkarkimet mbi normen e lejuar per zhurmat, ajrin, per ujin dhe per token, si dhe respektimin e kerkesave dhe te kushteve te Lejes Mjedisore te Tip it B.
- Menaxhimin e integruar te mbetjeve ne perputhje me kushtet e kontratave me operator te licencuar dhe parimet e mbrojtjes se mjedisit.
- Per tu mbrojtur nga zjarri i mundshem qe mund te bjere ne objekt do te vendosen shuars dhe hidrante per fikjen e zjarrit ne vende te dukshme ne ambientin ku zhvillohet veprimtaria.
- Per uljen e niveleve te zhurmave: Duke respektuar nivelin e lejuar te zhurmes, te percaktuar ne Udhezimin e perbashket nr. 2, dt 15.11.2023 "Per nivelin kufi te zhurmes per nje mjedis te dhene dhe per fushen e veprimtarive ekonomike-shoqerore".

### **Masa per sigurimin teknik dhe mbrojtja ne pune**

Aktiviteti qe zhvillon shoqeria "APEK servis plast" praktikisht nuk perben rrezik per stafin (punonjesit) e tij pasi i gjithe procesi i punes eshte i automatizuar cka e rrit sigurine e instalimeve/makinerive.

**Detyrimet e punedhenesit:** Punedhenesi vete ose nepermjet drejtuesit teknik qe ka te punesuar, duhet t'ju beje te ditur punemarresve:

1. Procesin e operacioneve ne teresi dhe te punes ne secilin prej instalimeve ku punon.
2. Shkaqet e aksidenteve dhe masat dhe per menjanimin e tyre.
3. Rregulloret e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune ne Republiken e Shqiperise, aktet ligjore dhe udhezimet ne zbatim te tyre, te leshuara nga dikasteret qe lidhen me to.
4. Rregullat e sigurimit teknik qe lidhen me frontin e punes, makinerite dhe profesionin qe kryen sipermarresi si individ per mbrojtjen e vetes dhe punonjesve te tjere.
5. Rregullat e pergjithshme te sigurimit teknik ne impiante dhe sheshin e punes, per tu mbrojtur nga makinerite, rrymes elektrike, shkarkesat atmosferike, etj.
6. Ndhimen e pare shendetesore.
7. Instruktimi paraprak dhe periodik i punonjesve, dokumentohet sipas formalitetit te percaktuar ne rregulloren e sigurimit teknik.
8. Ndalohet riparimi i avarive dhe punime te tjera kur makinerite jane ne levizje/procese pune.
9. Para se te fillohet nga puna behet kontrolli i frontit te punes, gjendja teknike e makinerive/pajisjeve etj.

**Detyrimet e punemarresit:** Detyrimet kryesore jane:

1. Te njoh rregulloren e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune te leshuar nga Inspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punes dhe ti zbatoje ato ne pune.
2. Te dije mire shkaqet e mundshme te aksidenteve per çdo proces pune.
3. Te siguroje veten dhe punonjesit e tjere gjate procesit te punes ne zbatim.



4. Kur konstaton shenja te nje avarie te mundshme qe eshte burim aksidenti, ne radhe te pare te marre masa per eliminimin e saj, nderkohe lajmeron gjithë punonjesit per rrezikun dhe ve ne dijeni drejtuesin teknik/perfaqesuesin ligjor te shoqerise.
5. Te perdoren mjetet e mbrojtjes individuale ne pune si: kapele, doreza, maskat e mbrojtjes dhe tapa veshi per zhurmat, uniforme te vecanta etj.
6. Te kete njohuri te mjaftueshme per ndihmen e shpejte.

- **MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.**

**Qellimet e monitorimit mjedisor**

Monitorimi per parametrin qe na intereson behet nepermjet matjeve te perseritura, qe merren me nje frekuence te mjaftueshme, per te bere te mundur vleresimin e gjendjes se mjedisit dhe ndryshimeve te tij ne kohe.

Qellimi i monitorimit mjedisor per prodhimin e produkteve plastike eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet nese zhvillimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standardet mjedisore qe lidhen me te, per te vleresuar shkallen e ndikimit (nese ka), si dhe per te vleresuar performancen mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

**Objektivat e Monitorimit:**

- Te krahasoje cilesine dhe gjendjen e mjedisit para fillimit te aktivitetit me ate gjate funksionimit te instalimeve.
- Te monitoroje emetimet (nese ka) ne te gjitha fazat e zhvillimeve te projektit ne perputhje me normat dhe standardet ligjore te Shqiperise dhe BE.
- Per te percaktuar efektivitetin e masave permiresuese te zbatuara nga aktoret zhvillues te aktivitetit ne rajon.
- Per te percaktuar impaktet afatgjate (nese ka).
- Per te percaktuar zgjatjen e kthimit ne normalitet te cilesise se mjedisit ne rajon, ne rastet kur vleresohet se ka ndikime dhe impakte ne te.
- Te krijojte nje arkive (regjister) te cilesise se mjedisit, nje baze te dhenash qe do te mund te perdoret ne te ardhmen.
- Per te garantuar pershtatshmerine e nje objekti mjedisor per tu perdorur per qellim te caktuar.

**Plani i Monitorimeve Mjedisore**

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokes, shkarkimeve urbane, menaxhimit te mbetjeve, zhurmave etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore persa i perket vrojttimeve, mbledhjes dhe analizave te mostrave. Ai synon ne mbledhjen e te dhenave per te vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror ne ndryshimet e mjedisit, ku ai eshte aktiv.

Objektivat kryesore te monitorimit jane:

- Per te zbuluar ndryshimet dhe per te karakterizuar saktesisht nga ana sasimore tendencat (prirjet) e zhvillimit te burimeve.
- Per te siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) te burimeve dhe shkaqeve te tyre.
- Per te evidentuar cilesine e mjediseseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

- Per te evidentuar cilesine e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetesor, me synim per te marre masat e nevojshme per permiresimin e tyre.
- Per te vleresuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve per menaxhimin e burimeve natyrore.

**Monitorimi eshte detyre e investitorit per pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 te ligjit "Per monitorimit e mjedisit ne Republiken e Shqiperise", kreu III, pika 10.**

Plani i monitorimit mjedisor eshte i inkorporuar ne projekt dhe perfshin inspektime dhe raportime rutine. Me poshte do te paraqesim disa monitorime qe do te realizohen per treguesit e trysnise ne mjedis qe jane detyre e investitorit ku ai do te bashkepusoj me instancat perkatese.

**Programi i monitorimit do te perdoret per te verifikuar qe te gjitha ndotjet e mundshme qe do t'i shkaktohen mjedisit nga funksionimi ne kete aktivitet. Investitori do te monitoroje vetem pikat per te cilat ai ndikon mbi to (pikat do te percaktohen nga organet kompetente), si dhe i dergojne keto te dhena ne Agjencine Kombetare te Mjedisit te pakten dy here ne vite, sipas legjislacionit perkates. Keto te dhena do te vihen ne dispozicion te inspektoreve te mjedisit gjate inspektimit te tyre.**

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjithe treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem, sipas kushteve te shfrytezimit te krijuar gjate aktivitetit, do te coje perfundimisht ne perfitimin e pamjeve te parashikuar ne projekt me siperfaqe te sistemuar dhe te gjelberuar, si dhe me nje ambient sherbimi te mire menaxhuar duke menduar per brezat pasardhes.

#### **f. KONSULTIMET NDERKUFITARE**

Zona ku zhvillohet do te zhvillohet aktiviteti nuk ka nevojte t'i nenshtrohet procesit te konsultimit nderkufitar.

#### **g. AUTORITETI VENDIMARRRES PER DHENIEN E AKTIT TE MIRATIMIT TE LEJES SE MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QE NDIQEN.**

Autoriteti miratues eshte Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit firmos per miratimin apo refuzimin e aplikimit per t'u pajisur me leje mjedisit te tipi B, me propozim nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacion e paraqitur nepermjet Qendres Kombetare te Biznesit.

Afati per marrjen ne shqyrtim te aplikimit per pajisjen me leje mjedisit te tipit B eshte 40 dite pune.

#### **h. ADRESA E AKM-SE, KU PUBLIKU MUND TE DERGOJE KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NE FORME ELEKTRONIKE, BRENTA 20 DITE NGA DATA E NJOFTIMIT.**

Faqja zyrtare e Agjencise Kombetare te Mjedisit: [akm.gov.al](http://akm.gov.al)

Pergatiti Raportin e Permbledhjes ne Gjuhe Jo-Teknike  
Eksperte Mjedisit (Nr.4959Prot, Nr. Identifikues:569)

Fatjona Levani

